



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**ZL.Anr.620/2017**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtarit të Lartë Ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e Ismet Batijarit, kryesues i KVV-së, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunale të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 10.11.2017, mori këtë:

## **V E N D I M**

**Refuzohet si e pabazuar ankesa** ZL.A.nr. 620/2017, e datës 09.11.2017 e parashtruar nga Ismet Batijarit, kryesues i KVV-së 2006A/04R, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve(KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunale të mbajtura më datë 22.10.2017,

## **A r s y e t i m**

PZAP-i, me datë 09.11.2017 ka pranuar një ankesë nga Ismet Batijarit, kryesues i KVV-së 2006A/04R në të cilën deklaroi se me datën 22.10.2017 në cilësinë e kryesuesit të KVV-së 2006A/04R në Prizren ka bërë gabim teknik të pa qëllim të gjatë numërimit të votave të kandidatëve për kuvend komunal të subjektit politik PDK. I njëjti thekson se gabimi ka qenë lëshim teknik dhe lidhur me këtë ka njoftuar KQZ-QNR.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmerisë së ankesës gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar**

Paneli gjeti se ankesa e Ismet Batijarit në cilësinë e kryesuesit të KVV-se në vendvotimin 2006A/04R është e pabazuar sepse vendvotimi në fjale veç është rinumëruar nga QNR-ja sipas vendimit të KQZ-së 2146-2017 i datës 01.11.2017

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa**  
ZL.A.nr. 620/2017 me datën 10.11.2017

**Kryesuese e Panelit**  
**Gyltenc Sylejmani**



*Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*